



ALEANCA E MAQEDONASVE PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Pustec më 29.09.2023

Lënda: Mbi ndërhyrjen e ambasadës bullgare dhe ekstremistëve bullgarë në procesin e censusit në zonat ku jeton komuniteti maqedonas në Shqipëri

Drejtuar: **Z. Edi RAMA**
Kryetar i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Z. Bajram BEGAJ
President i Republikës së Shqipërisë

Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Z. Igli HASANI
Ministër i Punëve të Jashtme

Z. Taulant BALLA
Ministër i Punëve të Brendshme

Znj. Erlinda BALLANCA
Avokati i Popullit

Z. Robert GAJDA
Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi

Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë

Prezencës së OSBE-së në Tiranë

Zyra e Këshillit të Europës në Tiranë

Ambasada amerikane në Tiranë

Ambasada maqedonase në Tiranë

Ambasadave të shteteve të Bashkimit Evropian në Tiranë

Sekretariatit të Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve në Strazburg

I nderuar kryeministër Rama,

Shpresoj që kjo letër t'ju gjejë mirë. Po ju shkruaj në emër të partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Evropian, parti politike që përfaqëson komunitetin maqedonas në Shqipëri. Partia jonë ka qenë thellësisht e shqetësuar për presionet që komuniteti maqedonas ndien me fillimin e censusit/regjistrimit të popullsisë që po kryhet në Shqipëri dhe ne ndihemi të detyruar të sjellim në vëmendjen tuaj disa çështje urgjente.

Minoriteti maqedonas në Shqipëri po përballet me një presion të jashtëm nga Bullgaria, për t'u deklaruar si bullgarë në census. Ky presion është veçanërisht alarmues, duke qenë se vjen pas njohjes nga Shqipëria të një minoriteti inekzistent bullgar brenda kufijve të saj ku sipas të dhënave zyrtare të censusve të realizuara ndër vite si dhe censusi i vitit 1989 dhe ai i fundit në vitin 2011, në Shqipëri nuk është vetdeklaruar asnjë banor si bullgar. Gjithashu edhe në Raportin e Veçantë për Gjendjen e të Drejtave të Minoriteteve në Shqipëri të Avokatit të Popullit në vitin 2014 por edhe në Opinionin e Parë, të Dytë, të Tretë dhe të Katërtë të Komitetit Këshillimor për Marrëveshjen Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare nuk flitet për minoritet bullgar në Shqipëri.

Kjo njohje ka hapur derën për një valë propagande bullgare me ndihmën e autoriteteve shqiptare që synon veçanërisht zonat përgjatë kufirit shqiptaro-maqedonas ku banojnë maqedonasit në Shqipëri, zonat e Prespës, Gorës, Gollobordës, fshati Vërnik, zona e Devollit.

Një nga masat për të krijuar një pakicë artificiale bullgare në Shqipëri, të cilën Bullgaria e zbaton, duke përfituar nga situata e dobët ekonomike e komuniteti maqedonas në Shqipëri dhe qytetarëve shqiptarë së bashku, është dhënia e pasaportave bullgare për të gjithë qytetarët shqiptarë. Maqedonasit dhe Shqiptarët paguajnë mijëra euro të marrin pasaportë bullgare dhe të shkojnë për të punuar në Perëndim, duke përdorur privilegjet e vendeve anëtare të BE-së. Ky është një biznes me vlerë miliona euro, që funksionon jo vetëm në Shqipëri, por në shumë vende jo të BE-së, si Maqedonia, Kosova, Serbia, Ukraina, Moldavia e të tjera.

Kur vendi ynë do të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian, besoj se të gjitha këto përpjekje të propagandës bullgare do të bien në ujë, duke shpërthyer si një flluskë sapuni. Atëherë asnjë qytetar shqiptar nuk do të paguajë Sofjes në mënyrë fiktive duke u deklaruar si bullgar si kusht për një pasaportë bullgare, për akses të lirë në tregun e brendshëm të BE-së.

Ajo që është më shqetësuese për ne është përshkallëzimi i taktikave të presionit dhe shantazhit të përdorura nga ambasada bullgare dhe ndërmjetësit që lehtësojnë lëshimin e pasaportave bullgare për shtetasit shqiptar në Shqipëri, në shumicën e rasteve janë edhe persona me pushtet. Këta qytetar, të cilët kanë shprehur interes për të marrë pasaporta bullgare, tani po detyrohen të

deklarohen si bullgarë gjatë censusit. Ata që refuzojnë ta bëjnë këtë, kërcënohen me refuzimin e aplikimeve për pasaportë dhe humbjen e investimeve financiare që kanë bërë në këtë proces.

Me fillimin e censusit kemi vërejtur një sërë shkeljesh nga ambasada bullgare. Disa ditë para fillimit të censusit në zonën e Gollobordës, Bashkia Bulqizë ka ardhur zv/presidentja bullgare ku ambasada bullgare ka ftuar në takim në fshatin Ostren anketuesit e INSTATIT për ti orientuar si ti deklarojnë banorët e Gollobordës. Në takim nuk kanë vajtur vetëm anketuesit e njësisë administrative Trebisht.

Ditën e dytë të fillimit të censusit më datë 19.09.2023 ambasadori bullgar ka vizituar fshatrat e zonës së Gollobordës, Bashkia Bulqizë për të lobuar tek banorët të deklarohen si bullgar. Në fshatin Trebisht në rrugë ka shprëndar tableta dhe telefona dhe ka lobuar banorët të regjistrohen si bullgar për të përfutur pasaporta bullgare. Gjatë vizitës në fshatrat e Gollobordës ka qënë i shoqëruar nga Policia e Shtetit.

Ditën e tretë të Censusit më datën 20.09.2023 ambasadori bullgar ka ardhur në Bashkinë Pustec për të shprëndar ndihma për qendrat shëndetësore dhe për të bërë fushatë që banorët të deklarohen si bullgar në census. Pasi kemi reaguar si parti në media para ardhjes së tij në Pustec, se ardhja e tij në Bashkinë Pustec është ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë dhe në procesin e censusit, ambasadori bullgar ka dorëzuar ndihmat në qendrën shëndetësore dhe ka ikur ga Bashkia Pustec. Edhe gjatë vizitës në Pustec ambasadori bullgar ka qënë i shoqëruar nga Policia e Shtetit.

Më datën 25.09.2023 diplomat të ambasadës bullgare kanë qënë në zonën e Gorës, Bashkia Kukës për të lobuar tek banorët të deklarohen bullgar.

Personat e komuniteti maqedonas të cilat kanë aplikuar për pasaporta bullgare dhe janë në proces për marrjen e pasaportës, si para fillimit të censusit ashtu edhe gjatë censusit po kontaktohen nga ambasada bullgare dhe nga ndërmjetësuesit e pasaportave të deklarohen bullgar në census përndryshe nuk do të marrin pasaportat. Në terren në zonat ku jeton komuniteti maqedonas po bëhet fushatë të deklarohen bullgarë dhe pasi të deklarohen do të kenë mundësi të martin vërtetim nga bashkitë se janë deklaruar bullgarë dhe menjëher do të marrin pasaportën bullgare.

Gjatë këto ditë të zhvillimit të censusit përveç ndërhyrjen e ambasadës bullgare dhe ndërmjetësuesve shqiptar të pasaportave, kemi pasur edhe kërcënime dhe shantazhe që komuniteti maqedonas në Shqipëri të deklarohet bullgarë përndryshe do ti meren pasaportat bullgare dhe do të ndërpritet procedura për ata kandidat të cilat janë në pritje të marrjes së pasaportës bullgare.

Viktor Stojanov, kryetar i fondacionit bullgar "Makedonia" nga Bullgaria në disa postime në facebook ka kërcënuar shtetasit shqiptar të deklarohen bullgar në census përndryshe do t'ua marrin shtetësin bullgare dhe do të ndërpritet procedura për aplikantët të cilat janë në pritje dhe se vetë do të vinte në Shqipëri dhe do të rinte deri në fund të censusit për të kontrolluar se si do të

regjistrohen banorët e komunitetit maqedonas. Këto kërcënime janë publikuar gjerësisht në media duke krijuar panik tek komuniteti maqedonas. Për këto kërcënime kemi lajmëruar autoritetet shqiptare, INSTATIN, Ministria e Punëve të Brendshme si dhe Prefekturat dhe kemi kërkuar që të merren masa ky person të mos hyjë në Shqipëri.

Pas nisjes së censusit, kryetari i fondacionit bullgar "Makedonia", Viktor Stojanov, ka reaguar përmes një postimi në facebook duke thënë se nëse banorët nuk regjistrohet si bullgar etnik në regjistrim, pasaportat e tyre bullgare do të tërhiqen menjëherë dhe se të gjitha proceset e tjera si dhënia e shtetësisë do të ndërpriten.

"Për të gjithë banorët e Bashkisë së Pustecit, Shqipëri: Nëse nuk regjistroheni tani si bullgarë etnikë në regjistrim, shtetësia bullgare do t'ju hiqet sa më shpejtë të jetë e mundur dhe se nëse jeni në proces të dhënies së shtetësisë, procedurat do të ndërpriten menjëherë. Tashmë kemi një rast të tillë. Mendoni për këtë", ka deklaruar Viktor Stojanov, kryetari i fondacionit të bullgar "Makedonia".

Ndërkaq, në fillim të kësaj jave kur filloi censusi në Shqipëri, fondacioni "Makedonia", dhe Viktor Stojanov përmes një postimi në rrjetin social facebook u bëri thirrje banorëve të Shqipërisë për të mos e anashkaluar përkatësinë etnike dhe të regjistrohen si bullgar etnikë.

"Apel nga fondacioni "Makedonia" për bullgarët në Shqipëri- regjistrohuni si bullgarë etnik, me gjuhën amtare bullgare. I kujtojmë edhe ata që kanë shtetësi bullgare se janë të detyruar ndaj Bullgarisë të shkruhen si bullgarë, ashtu si bullgarët me origjinë dhe dëshirojnë të marrin shtetësi bullgare në të ardhmen, të shkruajnë vetë si bullgarë etnik dhe në asnjë çast të mos anashkalojnë çështjen për përkatësinë etnike", ka deklaruar fondacioni bullgar "Makedonia" si dhe Viktor Stojanov.

Gjithashu në faqen e tij në facebook Viktor Stojanov ka shkruar se :Do t'ua marim nënshtetësinë bullgare. Se a do të deklarohen shqiptar, maqedonas apo ndonjë gjë ndryshe nga bullgarët. Do ti kontrollojmë një nga një dhe nëse nuk janë deklaruar do t'ua marim nënshtetësinë. Gjithashtu kush dëshiron shtetësi bullgare deklarohuni bullgar".

Ndërsa një muaj përpara se të fillonte censusi në Shqipëri Viktor Stojanov ka qënë në Bashkinë Pustec dhe në një postim në facebook ku ka dale me flamurin bullgar në Pustec shkruan "I nxorëm flamujt në Pustec, Shqipëri. Për një muaj fillon regjistrimi i popullsisë. Të gjithë që kanë shtetësi bullgare ose janë në procedur për marrjen e saj, ose duan ta marin të deklarohen bullgarë në regjistrim. Shumicën e kohës unë personalisht do të jemë në Pustec dhe Shqipëri. Në pret shumë punë në Pustec".

Viktor Stojanov është emër i njohur për Policinë e Shtetit pasi vitet e fundit vjen shpeshë në zonat ku jeton komuniteti maqedonas me grupe nga ekstremi i djathë nga Bullgaria duke krijuar incidente të ndryshme. Edhe pse e kemi denocuar disa herë Policia e Shtetit e ka toleruar aktivitetin e tij në zonat e komunitetit maqedonas në Shqipëri. Mendojmë se të gjitha këto

aktivite në Shqipëri të ekstremit të djathtë nga Bullgaria, të Viktor Stojanovit, Adrian Asenov, anëtar i partisë nacionaliste "Ataka" etj janë të mbështetura nga qarqet bullgare por edhe ato ruse për të krijuar trazira në Shqipëri. Viktor Stojanovit i është ndaluar hyrja në Maqedoni nga autoritetet maqedonase.

Viktor Stojanov gjithashtu ka kërcënuar edhe studentët e komunitetit maqedonas të cilat studiojnë në Bullgari si dhe po kërcënon shumë persona të komunitetit maqedonas në Shqipëri të cilat deklarohen publikisht se janë pjesëtar të komunitetit maqedonas.

Edhe pse kemi lajmëruar autoritet shqiptare, pas kërcënimeve publike që ka bërë, të mos lejojnë hyrjen e tij në Shqipëri dhe të ndërhyje në procesin e censusit, për fat të keq autoritet shqiptare nuk kanë marrë asnjë masë dhe Viktor Stojanov së bashku me ekstremistë të tjerë bullgarë nga data 27.09.2023 ka hyrë në territorin shqiptar. Më datën 27.09.2023 ka vizituar fshatrat e zonës së Gollobordës ku ka bërë fushatë banorët të deklarohen si bullgarë në census dhe gjithë vizita e tij është e pasqyruar në profilin e tij në facebook ku në fshatin Ostren dhe Trebisht nxënësve i ka shpërndarë tableta dhe materiale shkollore duke i filmuar dhe nxjerë në facebook dhe duke bërë propagandë. Ka kontaktuar edhe anketuesit e INSTATIT ku në njërin nga fotot e tij të publikuara në facebook duket se në fshatin Ostren është takuar me Antoni Kurti i cili është anketues i INSTATIT për njësinë administrative Ostren, Bashkia Bulqizë.

Këto ditë Viktor Stojanov pritet të vijë edhe në zona të tjera ku jeton komuniteti maqedonas në Shqipëri.

Autoritete shqiptare nuk po marrin asnjë masë dhe po ndihmojnë gjithë këto aktivitete bullgare.

I nderuar Z.Kryeministër

Antarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është vendim strategjik i vendit tonë si dhe kërkes e qytetarëve shqiptar pavarësisht përkatësisë etnike. Komuniteti maqedonas në Republikën e Shqipërisë nuk mund të jetë dëmë kolateral në rrugën e Shqipërisë drejt antarësimin Europian. Shqipëria duhet të reagoj dhe të mbroj komunitetin maqedonas në territorin e saj nga përpjekja e Bullgarisë për asimilim e tij.

Shqipëria duhet të thotë hapur se përpjekjet e Sofjes për të asimiluar maqedonasit në Shqipëri si bullgarë nuk janë fqinjësi të mirë, por një sulm i hapur ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Shqipërisë dhe përfaqësojnë ndërhyrjen e rëndë të Bullgarisë në punët e brendshme të Shqipërisë.

Me respekt kërkojmë që qeveria shqiptare të marrë masa të menjëhershme për të adresuar këtë çështje dhe për të mbrojtur të drejtat dhe identitetin e minoritetit maqedonas në Shqipëri. Presioni i ushtruar nga diplomatët bullgarë, ndërmjetësuesit e pasaportave, si dhe të ekstermistëve bullgar si Viktor Stojanov etj është një shkelje e qartë e parimeve të vetëidentifikimit të lirë dhe të drejtë gjatë procesit të censusit. Ne besojmë se të gjithë qytetarët

duhet të kenë lirinë për të deklaruar identitetin e tyre të vërtetë pa ndikime apo kërcënime të panevojshme të jashtme.

Për më tepër, ne kërkojmë nga institucionet shqiptare që të mbrojnë minoritetin maqedonas nga çdo politikë asimiluese e ndjekur nga Bullgaria. Bashkimi European nuk duhet të keqpërdoret si një mjet për të ushtruar presion ndaj Shqipërisë në rrugëtimin e saj të integritimit european. Është thelbësore që angazhimi i Shqipërisë për respektimin e të drejtave dhe identitetit të të gjithë qytetarëve të saj, përfshirë minoritetet, të mbetet i palëkundur.

Si përfundim, ju kërkojmë me mirësi që të ndërmerri veprime të menjëhershme dhe vendimtare për të siguruar që maqedonasit në Shqipëri të lejohen të deklarojnë lirisht identitetin e tyre të vërtetë gjatë censusit pa presione apo nxitje të jashtme.

Për të gjitha këto shqetësime që kemi ngritur mësipër por edhe për gjera të tjera në lidhje me përpjekjet e Bullgarisë për asimilimin e komunitetit maqedonas në Shqipëri jemi të gatshëm një delegacion i partisë Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European t'ju informojmë në një takim që ju do na caktoni.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë edhe foto nga kërcënimet publike dhe aktivitete në terren në Shqipëri të ekstremistëve bullgar Viktor Stojanov dhe Adrian Ase nov.

Faleminderit për vëmendjen Tuaj për këtë çështje të ngutshme. Ne presim mbështetjen Tuaj në mbrojtjen e të drejtave dhe identitetit të komuniteti maqedonas në Shqipëri.

Me respekt

**Kryetar i partisë
Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European
Vasil STERJOVSKI**

